



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dostuzuar Prilježen/Prodato Received/Delivered	16.03.2023	3	viti god year
Organ /Njesta Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SIKIMSHOK	2744/2023		113



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr148/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetare Ardita Haxhnikaj-Demi, dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.148/2023 të datës 25.01.2023 të parashtruar nga ankuesi, të cilin e përfaqëson me autorizim avokat nga Drenasi, kundër organit të punësimit/Qendra e Studentëve të Universitetit të Prishtinës, në çështjen juridike "masë disiplinore, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 16.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* në të vendosur lidhur me ankesën A.nr.148/2023 të datës 25.01.2023, të parashtruar nga ankuesi.
- II. Lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent/Komisionit për Ankesa në Qendrën e Studentëve në Universitetin e Prishtinës.

A r s y e t i m

Komisioni Disiplinore pas pranimit të raportit nga Drejtori i Përgjithshëm i Qendrës së Studenteve për shkelje të supozuar disiplinore nga nëpunësi, mirëmbledhës vendimit me Nr.301 të datës 13.12.2022 nëpunësin e ka pezulluar nga marrëdhënia e punës, ndërsa me vendimin me Nr.302 të datës 14.12.2022 për plotësimin e vendimit në paragrafin II të këtij vendimi të njëjtit i kanë lejuar se ndaj të njëjtit do të kompensohet 50% e pagës mujore deri sa do të zgjat periudha e pezullimit.

Ankuesi me datë 25.01.2023 përmes përfaqësuesit me autorizim avokat ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 806/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vendimit Nr.301/2022 të datës 13.12.2022 dhe plotësimin e vendimit Nr.302/2022 të datës 14.12.2022, të lëshuar nga Kryetari i Komisionit Disiplinore lidhur me pezullimin nga marrëdhënia e punës.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 03.02.2023, ka proceduar kërkesën e ankuesit për përgjigje në ankesë në Qendrën e Studentëve në Universitetin e Prishtinës . Ndërsa Këshilli më datë 20.02.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër VK.nr.204/2022 të datës 08.03.2023, ka vazhduar afatin për vendimmarrje edhe për 10 ditë pune lidhur me ankesën A.Nr.148/2023 e datës 25.01.2023 të parashtruar nga ankuesi

Kolegji i Këshillit nga administrimi i provave të lëndës ka gjetur se ankuesi është i punësuar në Qendrën e Studentëve në Universitetin e Prishtinës dhe se i njëjti është i emëruar sipas Akt emërimit të datës 01.12.2020 dhe ushtron pozitën e punës "Receptionist". Tutje në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se në listën e propozuar lidhur me titujt e punës nga organi i punësimit, drejtuar KPMSHCK-se ankuesi është propozuar në klasën *Teknik-Administrativ*.

Kolegji i Këshillit po ashtu duke i shqyrtuar shkresat e lëndës të dërguara nga organi i punësimit pas analizimit të emailit të Udhëheqësit të Divizionit të Pagave për Zhvillimin e Strukturave Funktionale në DMZP, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm në Qendrën e Studentëve në Universitetin e Prishtinës ka cituar se; *Qendra e Studenteve ka statusin e miratuar nga Ministri i MASHT-it me datën 05.05.2017 dhe natyrisht që edhe nëpunësit e Qendrës së Studenteve të Universitetit të Prishtinës e kanë statusin e nëpunësit të Shërbimit Publik mbi bazën e paragrafit 4 të nenit 2 të Ligjit NR.06/L-114 për Zyrtar Publikë.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke ju referuar nenit 2 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se zyrtarët publikë ndahen në: *nëpunës të Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); nëpunësi i Shërbimit Publik; nëpunësi i Kabinetit; dhe nëpunës administrativ dhe mbështetës*" si dhe bazuar në paragrafin 6 të të njëjtit nen ku theksohet se: *"Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike"*, konstatoi se pozita "Receptionist" hyn në kategorinë e nëpunësve të shërbimit administrativ dhe mbështetës, rrjedhimisht pozita në fjalë nuk është pozitë e shërbimit civil.

Lidhur me procedurën e ushtrimit të mjeteve juridike në mbrojtje të të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenit 78 dhe 79 të Ligjit 03/L-212 të Punës, thekson së nëpunësi administrativo-teknik dhe mbështetës fillimisht duhet të ankohen tek punëdhënësi dhe më pas mund të filloj kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Në kuptim të nenit 101 paragrafi 2 të Kushtetues së Republikës së Kosovës si dhe nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e



Ankesave konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.148/2023 të datës 25.01.2023 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_, pasi që ankuesi nuk e ka statusin e nëpunësit civil.

Marr parasysh konstatimin si me lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr. 148/2023 të datës 25.01.2023, Kolegji duke u bazuar në nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative vendosi që lënda ti dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent, në këtë rast Komisionit për Ankesa në Qendrën e Studentëve në Universitetin e Prishtinës.


Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit, udhëzon palën për ushtrimin e mjeteve juridike bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 24 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.*

Andaj pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.148/2023

Ilire MEHMETI-SHAQIRI

  
Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI



**Vendimi i dorëzohet:**

- Përfaqësuesit me autorizim avokat
- Komisionit për Ankesa në Qendrën e Studentëve në Universitetin e Prishtinës.;
- Udhëheqësit të Personelit në Qendrën e Studentëve në Universitetin e Prishtinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

